

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Realiteti politik i ditëve të sotme, për fat të keq, është i dërrmuar.

Ndoshta të flasësh sot për kulturën, në një kohë kur antivlerat e një karakteropati kanë mbjellë mjerim të përgjithshëm, mund të jetë pak utopike në sytë e qytetarëve shqiptarë. Por, gjithsesi, disa të vërteta duhen thënë. Duhet të thuhet, sepse mania e një Kryeministri ka uzurpuar edhe kulturën pa asnjë mëshirë, ashtu siç, në fakt, ka uzurpuar edhe çdo sektor tjetër.

Po e nis analizën time me një raport të nxjerrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ku thuhet: “22 monumente janë shkatërruar si pasojë e keqmenaxhimit nga Ministria e Kulturës”. Nga ana tjetër, Ministria e Kulturës del me parulla, tipike komuniste, që ngjajnë bukur në letër dhe janë material thjesht për propagandë.

Ju thoni: “Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale janë pasuri kombëtare e popullit tonë ndër breza”. Rëndon, si në çdo strategji, nuk ka asnjë fjali shpjeguese për mënyrën si do të bëhet kjo ruajtje dhe mbrojtje. Si? Në çfarë mënyre? Duke shkatërruar monumente të tjera, apo edhe ata të KLSH-së i kanë rrahur te dera e SHQUP-it?

Ne sot jemi duke shqyrtuar buxhetin dhe në këtë pikë pak na intereson vullneti i mirë i Ministrisë së Kulturës, edhe pse vullnet të mirë nuk ka sesi të ketë.

Raporti i KLSH-së ka gjetur se “Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e monumenteve të kulturës nuk e kanë orientuar veprimtarinë e tyre në mënyrë efektive; 122 monumente janë plotësisht të shkatërruara, 884 monumente janë në gjendje të pranueshme, por që kanë nevojë për restaurim; 745 objekte janë në gjendje të mirë dhe në nevojë për një mirëmbajtje të vazhdueshme, 98 objekte janë të tjetërsuara, si dhe 15 objekte janë pa kartelë”.

Po sipas KLSH-së, Ministria e Kulturës e ka lënë sistemin kombëtar të kujdesit ndaj trashëgimisë kulturore pa inspektorat, i cili duhej të kishte në dorë mundësinë e ndëshkimit ndaj atyre që abuzojnë, i shkatërrojnë apo i tjetërsojnë monumentet e kulturës.

Për t'u rikthyer te pseudobuxheti, i kuruar thjesht me parrulla, vazhdimisht përdoret fjala "mbrojtje". Por çfarë mbroni dhe çfarë mbrojtjeje keni parasysh, kur ju jeni përgjegjës për shkatërrimin e 122 monumenteve kulturore, kur ju nuk keni as inspektorat që ndëshkon ata që i dëmtojnë monumentet?

Një tjetër prioritet i shpallur nga ju është zbatimi me sukses i platformës kombëtare "Edukimi përmes artit" në të gjitha institucionet e artit dhe të trashëgimisë në sistemin arsimor parauniversitar. E thënë në këtë mënyrë, nuk kuptohet se cilat janë institucionet e artit dhe të trashëgimisë në sistemin arsimor parauniversitar.

Megjithëse e kemi shprehur edhe më herët, ndiej se ka nevojë të thuhet edhe një herë në këtë sallë, se me planin e ri mësimor, të miratuar nga zonja Nikolla më 28.12.2017, është hequr tërësisht si në kurrikulën bërthamë, ashtu edhe në kurrikulën me zgjedhje, lënda e trashëgimisë kulturore. Praktikisht, e keni thujse të pamundur ta promovoni trashëgiminë kulturore në arsimin parauniversitar, përveç aktiviteteve rutinë që mund të bëhen nëpër shkolla. Edhe këto aktivitete zhvillohen thjesht në funksion të propagandës suaj.

Një investigim i Citizens Channel për monumentet në Tiranë zbuloi se sot kryeqyteti numëron 36 monumente më pak. Vilat e vjetra të kryeqytetit janë zëvendësuar me pallate përmes heqjes së statusit të mbrojtjes apo edhe shpalljes së tyre si të dëmtuara.

Sipas analizës së kryer nga "Citizens", për 45 godina/vila me statusin "Monument kulture", të marra në studim, në Tiranë kemi 36 urdhra për heqje të statusit, veprim që ka çuar në shembjen e 17 vilave/godinave historike dhe zëvendësimit të tyre me pallate. Çfarë komenti ka Ministria e Kulturës për këtë fakt? Sigurisht, nuk figuron gjëkund në strategjitë e kartonit asnjë fjalë për atë çka po i ndodh Tiranës sot. Fundja, ju jeni po të njëjtët barbarë që shembët Teatrin Kombëtar tinëzisht në mes të Tiranës, as gjermani nuk e ka bërë këtë me kombin shqiptar. Ç'u bë se prishët edhe 45 godina të tjera?

Ende nuk na keni qartësuar si do të bëni realitet një prioritet, të trumbetuar më parë nga ju, të tërhiqni të rejat dhe të rinjtë tanë në zeje, që janë gati duke u harruar, në përvetësimin e profesionit të restauruesit, në mbajtjen gjallë të disa veglave unike muzikore, si: gajdja, çiftelia, curlja e të tjera.

Sigurisht që dëshira jonë, sidomos imja, edhe si instrumentiste, është që të rinjtë tanë, dhe jo vetëm ata të Universitetit të Arteve, të mund të realizojnë aktivitete kulturore e artistike. Arti i vërtetë sjell veçse zhvillim.

Sidoqoftë në Universitetin e Arteve, sikundër ju e dini, ka ende mungesë të mjediseve dhe godinave, që vijojnë edhe sot të jenë në rikonstrukcion. Si do të mund të bëhen këto aktivitete, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me Paktin e Universitetit, të cilin e keni kthyer në legjendë urbane që në protestën e studentëve?

Në relacion ju përmendni përmirësimin e gjendjes fizike të Muzeut Kombëtar, të parqeve kombëtare e të tjera, por në materialin që na keni sjellë investimet tuaja në këtë drejtim janë në zona të kufizuara. Në këtë rast lindin dyshimet dhe pyetjet: përse shtatë projekte dhe një restaurim ndodhin vetëm në këtë zonë dhe asnjë projekt i këtij Instituti në zona të tjera? Pra, nuk ka një shpërndarje të mirë territoriale. Po zonat e tjera do t'i mbulonin me PPP, apo keni një tjetër plan investimesh, që ne nuk po e shohim në relacionin e paraqitur nga Ministria e Kulturës?

Në investimet e Institutit të Kulturës ne shohim me dyshime të forta se Bashkisë së Tiranës i është dhënë një prioritet i veçantë, duke qenë se jemi, ndoshta, edhe në prag të një viti elektoral. Edhe në këtë rast shohim më shumë premtime që ngjajnë me një strategji 2-3-vjeçare të Ministrisë së Kulturës, por nuk e dimë se çfarë do të realizohet në vitin 2023? Cili është buxheti i dedikuar për këtë qëllim?

Konkretisht, do të rriten objektet e restauruara, krahasimisht me vitin 2021, por nuk e dimë sa do të jenë në vitin 2023 dhe sa është fondi i akorduar për to.

Rritet me 10 mijë numri i vizitorëve në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022, por a ka ndonjë studim për këtë numër turistësh apo vizitorësh që do të rritet me afërsisht 5%?

Premtoni si rezultat të pritshëm rritjen e aktiviteteve të mbështetura nga Ministria e Kulturës, nga 80 të tilla në vitin 2021, në 122 në vitin 2024, por nuk e reflektoni në buxhet sa do të jetë numri i aktiviteteve për vitin 2023.

A mund të na specifikoni, pasi është e paqartë në relacionin e dërguar nga ju, se cilat janë dukuritë e kulturës jomateriale?

Në pritshmëritë që keni për artin e kulturën rendisni dëshira, por jo rezultate të matshme. Për shembull, si do ta matim rritjen e numrit dhe të cilësisë në të gjitha zhanret? Si arrihet integrimi dhe angazhimi i të

rinjve e promovimi i tyre në fushën e artit dhe të kulturës? Relacioni nuk na tregon as mekanizmat, as fondet dhe as institucionet që do të jenë përgjegjëse.

Premtoni 60 projekte në konkurrim. Përse ky numër dhe jo më shumë, apo më pak? A keni ndonjë studim që tregon sa i kemi nevojat, kapacitetet njerëzore? Cili është instrumenti, metodologjia që keni përdorur që keni dalë te numri 60?

Mbetet i paqartë në relacion se cili do të jetë edhe roli i PPP-ve në vitin 2023. A janë planifikuar parqe, muze apo objekte kulturore, që do të lihen në dorë të privatit?

Ajo çka vlen të theksohet në këtë pikë është se ka një ulje progresive të buxhetit të kulturës nga viti në vit. Konkretisht në vitin 2020 ishte 0,37%, në vitin 2021 ishte 0,35%, e më pas 0,33% në vitin 2022. Praktikiisht, çdo vit ka një rënie me 0,02%. Nga kjo përqindje, gati 70% e buxhetit shkon për rroga dhe shpenzime operative, duke lënë një përqindje minimale për pjesën e mbetur.

Normalisht, bën sens që në propozimin e bërë nga Ministria e Kulturës të mos kemi asgjë konkrete, sepse shifrat janë vërtet qesharake.

Jam e bindur që mund të dilni tani dhe të përgënjeshtroini faktet e mia, të na thoni edhe “bedelë”, “bisht i non-grata-ve”, “të pafe e pa iman”, por kjo është e vërteta, të nderuar, këto janë faktet dhe ju nuk keni argumente për të sjellë në tavolinë, përveç ofendimeve, të cilat, për hir të vërtetës, janë paradoksi më i madh!

Flisni për fe ju, që jeni pjella e kolerës komuniste që, meqë jemi edhe te kultura, nuk latë kishë, xhami, prift pa vlarë, pa djegur dhe pa persekutuar!

Flisni ju për shpullat e SHQUP-it, kur të gjithë shqiptarët e dinë që ju jeni dhunuesi më i madh që qarkullon në politikë!

Turp! Mëkat! Haram!

Faleminderit!